

**GJENDJA ME GRIPIN/SËMUNDJET E NGJASHME ME GRIPIN
SEZONI 2025/2026
-Informacion përmbyllës-**

*Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse
Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut*

PËRMBAJTJA

TË DHËNA JAVORE	Error! Bookmark not defined.
<i>Mbikëqyrja epidemiologjike</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<i>Mbikëqyrja virologjike</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
TË DHËNA KUMULATIVE PËR SEZONIN 2025/2026	Error! Bookmark not defined.
<i>Mbikëqyrja epidemiologjike</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
Shpërndarja gjeografike.....	Error! Bookmark not defined.
Shpërndarja sipas grupmoshave	Error! Bookmark not defined.
Shpërndarja kohore	Error! Bookmark not defined.
Vdekshmëria si pasojë e gripit.....	Error! Bookmark not defined.
<i>Mbikëqyrja virologjike</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
KOMENT EPIDEMIOLOGJIK	Error! Bookmark not defined.
MASAT E PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT.....	Error! Bookmark not defined.
Çfarë duhet të bëni nëse sëmureni nga gripit?	Error! Bookmark not defined.
VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT	Error! Bookmark not defined.
RAJONI EVROPIAN	Error! Bookmark not defined.

TË DHËNA JAVORE


Mbikëqyrja epidemiologjike

Gjatë javës së 20 të vitit 2026 (nga 11-17.05.2026), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar **58 (I=3,2/100.000)** të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 15,9% më pak se javën që shkoi (69).

Në javën e 20 të vitit të kaluar janë regjistruar 35 të sëmurë (rritje për 65,7%), ndërsa krahasuar me modelin për 15 sezonet e fundit (27) është regjistruar një rënie prej 2,1 herë.

Incidenca e raportuar është jashtë aktivitetit sezonal të virusit të gripit.

Grafiku 1. *Niveli i intenzitetit dhe shpërndarja javore e të sëmurëve nga gripi/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores së pritur epidemiologjike 2010-2025, sezoni 2024/2025 dhe sezoni 2025/2026*



Sa i përket grupmoshës, tek grupmosha nga 15-64 vjet janë regjistruar 34 të sëmurë, ndërsa tek grupmoshat e tjera numri i të sëmurëve është nën 8. Incidencë më e lartë është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet (8,3/100.000).

Personat e sëmurë të kësaj jave janë regjistruar në 4 QSHP/NJR, Prilep – 18, Shkup - 18, Tetovë – 14 dhe Shtip – 8, ndërsa në qytetet e tjera nuk janë regjistruar persona të sëmurë nga gripi

Mbikëqyrja virologjike

Gjatë javës së 20 të raportimit pranë pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV-së kanë arritur 34 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV. Nga materialet e testuara nuk kanë rezultuar raste pozitive me Influenza dhe me SARS-CoV-2.

Është regjistruar edhe 1 rast pozitiv me RSV-A.

TË DHËNA KUMULATIVE PËR SEZONIN 2025/2026

Mbikëqyrja epidemiologjike

Gjatë sezonit 2025/2026 numri i përgjithshëm i të prekurve nga gripi/sëmundje të ngjashme me gripin është **17.252 (I=939,3/100.000)**.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=26.040) numri i rasteve të raportuara është zvogëluar për 33,7%, ndërsa krahasuar me modelin për 15 vitet e fundit (n=20.811) është regjistruar një rënie prej 17,1%.


Të sëmurë janë regjistruar në 31 QShP/NjR.

Shpërndarja gjeografike

Numri më i madh i të sëmurëve (n=5.618; 32,6%) është regjistruar në Shkup, Tetovë (n=1.756; 10,2%), Prilep (n=1.288; 7,5%) dhe Kumanovë (n=1.175; 6,8%) (Grafiku 2).

Incidenca më e lartë kumulative prej 2.754,5/100.000 është regjistruar në Dibër. Incidencë prej mbi 1.500,0/100.000 banorë është regjistruar në Makedonski Brod dhe Ohër (Grafiku 2) (Tabela 1).


Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve me grip sipas QShP/NJR dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2025/2026



Shpërndarja sipas grupmoshave


Sa i përket shpërndarjes të të sëmurëve sipas grupmoshës, numri më i madh i të sëmurëve bëjnë pjesë në grupmoshën që përfshin numrin më të madh të popullatës (nga 15-64 vjet) – 10.041 raste (58,2%), ndërsa incidencë më e lartë (2.086,6/100.000) është regjistruar tek fëmijët nga 0-4 vjet (n=2.992) dhe 5-14 vjet (1.352,3/100.000). (Grafiku 3)

Grafiku 3. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca në 100.000 banorë e rasteve me grip sipas grupmoshës, sezoni 2025/2026



Nëse analizojmë numrin e të sëmurëve sipas javës, vërejmë se gjatë pjesës më të madhe të sezonit dominojnë më të vegjlit, fëmijët nga 0-4 dhe 5-14 vjet. (Grafiku 4)

Grafiku 4. Shpërndarja javore e rasteve me grip sipas grupmoshës - incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2025/2026




Shpërndarja kohore

Ky sezon karakterizohet nga një numër më i ulët rastesh krahasuar me modelin 15-vjeçar. Numri i rasteve të regjistruara të gripit/sëmundjeve të ngjashme me gripin arriti kulmin në javën e 2-të të vitit 2026 (n=2.322), tre javë më herët se sa pritej sipas modelit MEM.

Analiza e numrit të rasteve të gripit sezonal sipas muajve tregon një rritje të shpejtë të rasteve dhe një kulminacion në janar 2026 (n=9.315) me një rënie graduale deri në fund të sezonit.

Nga numri i përgjithshëm i rasteve në sezonin 2025/2026, 2.100 persona ose 12,2% u regjistruan gjatë vitit 2025. Pjesa e mbetur prej 87,8% ose 15.152 persona u regjistruan në vitin 2026.

Grafiku 5. Shpërndarja e rasteve të gripit sezonal sipas muajve, sezoni 2025/2026



Vdekshmëria si pasojë e gripit

Gjatë sezonit 2025/26 janë regjistruar 4 raste të vdekjes si pasojë e gripit, dhe atë nga Shkupi (n=2), Tetova (n=1) dhe Kavadari (n=1) dhe bëjnë pjesë në grupmoshën mbi 65 vjet (n=4) dhe 15-64 vjet (n=1).

Të gjitha rastet kanë ndërruar jetë në kushte spitalore, kanë pasur komorbiditete dhe nuk kane qenë të vaksinuar kundër gripit sezonal.

Tek tre persona është vërtetuar Influenza A – e pasubtipizuar, ndërsa tek një – Influenza A/H3.

Mbikëqyrja virologjike

Deri më tani në sezonin 2025/26, pranë laboratorit të virologjisë në Institutin e Shëndetit Publik të RMV-së kanë arritur 1.411 materiale nga mbikëqyrja rutinore dhe SARI për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV.

Të gjitha materialet janë testuar paralelisht për prani të virusit të influencës, SARS-CoV-2 и/или RSV. (Tabela 1, Grafiku 6)

Tabela 1. Shpërndarja e numrit dhe përqindjes së mostrave pozitive nga mbikëqyrja rutinore dhe snetinel sipas origjinës, RMV, 2025/2026

Lloji dhe nënloji i virusit	Prejardhja		Sezoni 2025/2026	
	Rutinore	Sentinel SARI	Numri	%
Influenza A	65	62	127	60,5%
Influenza A/H1pdm	20	22	42	33,1%
Influenza A/H3	35	35	70	55,1%


Influenza A e pasubtipizuar	10	5	15	11,8%
Influenza B	0	0	0	0%
Influenza B Victoria	0	0	0	0%
Influenza B – linjë e papërcaktuar	0	0	0	0%
SARS-CoV-2	12	17	29	-
RSV	28	140	168	-
RSV-A	9	41	50	29,8%
RSV-B	17	96	113	67,3%
RSV i pasubtipizuar	2	3	5	2,9%

Janë detektuar 127 raste pozitive të gripit. Janë regjistruar 29 raste pozitive të SARS-CoV-2. Pastaj, janë regjistruar 168 raste pozitive të virusit respirator sincial (RSV). (Tabela 1)

Tek 4 persona është regjistruar bashkinfeksion i Influenza dhe RSV, ndërsa tek 8 persona bashkinfeksion i RSV dhe SARS-CoV-2.

Pastaj, janë detektuar 5 viruse të tjera respiratore tek mostrat e analizuara (Bordetella, Adeno virus, Parainfluenzae 4).

Grafiku 6. Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes të mostrave pozitive të gripit, mbikëqyrja rutinore dhe sentinel, 2025/2026 RMV,



KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Sezoni 2025/2026 karakterizohet nga një numër më i ulët i rasteve të raportuara dhe një incidencë më e ulët krahasuar me mesataren, si dhe një përqindje më e ulët e pozitivitetit (9%) të numrit të përgjithshëm të personave të testuar krahasuar me sezonin e mëparshëm, i cili ndryshonte gjatë javëve.

Pragu për hyrjen në sezon (virologjik), pra përqindja e pozitivitetit të mostrave mbi 10%, është regjistruar nga java e 50-të e vitit 2025 deri në javën e 5-të të vitit 2026. Sipas të dhënave epidemiologjike, aktiviteti sezonal është regjistruar nga java e 51-të e vitit 2025 deri në javën e 9-të të vitit 2026.

Influenza A dominon sezonin, dhe është regjistruar bashkë-dominim i Influcencës AH3 dhe Influcencës A(H1)pdm.

MASA TË PËRGJITHSHME PËR PARANDALIM

*Burimi: <https://sezonskigrip.mk/>

Masat e përgjithshme për mbrojtje nga gripi kanë për qëllim parandalimin e të gjitha sëmundjeve akute të frymëmarrjes dhe mund të jenë shumë të dobishme, veçanërisht nëse zbatohen gjatë gjithë periudhës së dimrit:

- Evitoni grumbullimin dhe qëndrimin në dhoma ku qëndrojnë më shumë njerëz, sidomos kontaktin e ngushtë me njerëz që janë të sëmurë ose që kolliten, teshtijnë, kanë temperaturë të lartë të trupit.
- Lani duart shpesh me sapun dhe ujë ose me dezinfektues.
- Ngrohni dhomat në të cilat qëndroni dhe ajrosini ato shpesh.
- Këshillohet të vishni rroba të ngrohta, në disa shtresa, të bëni banjo të ngrohta.
- Pini pije të nxehta (çajra dhe supa), lëngje frutash, ujë me limon.
- Hani produkte të freskëta të pasura me vitamina dhe minerale, më së miri fruta dhe perime që janë më të mira e të nevojshme për trupin. Produktet e pasura me vitaminë C (limona, portokalle) janë veçanërisht të dobishme. Nëse produktet ushqimore të freskëta nuk janë gjithmonë të disponueshme, mund të përdoren edhe pije dhe preparate multivitaminike.
- Praktikoni një stil jetese dhe zakone të shëndetshme, duke përfshirë këtu gjumin dhe pushimin e mirë, të ushqyerit e shëndetshëm, ruajtjen e aktivitetit fizik dhe mendor dhe uljen e stresit.

Sistemi i fortë imunologjik do t'ju ndihmojë të qëndroni të shëndetshëm ose ta përballoni më lehtë gripin dhe sëmundjet e ngjashme me gripin. Megjithatë, edhe nëse jeni plotësisht të shëndetshëm dhe keni një sistem imunologjik të fortë, prapëseprapë mund të sëmureni me grip ose një sëmundje të ngjashme me gripin.

Çfarë duhet të bëni nëse sëmureni nga gripi?

Ndiqu këto rekomandime:

- Qëndroni në shtëpi dhe mos shkoni në punë, shkollë ose në vende ku ka shumë njerëz.
- Pushoni dhe konsumoni shumë lëngje dhe ushqime të lehta.
- Shmangni kontaktin e ngushtë me njerëzit me të cilët jetoni, mos pranoni vizitorë ndërsa jeni të sëmurë.
- Mbuloni hundën dhe gojën me një pecetë kur kolliteni dhe teshtini. Pas përdorimit, hidhini ato në plehra.
- Mbani maskë mbrojtëse kur kontaktoni me të afërmit tuaj në shtëpi, kur kolliteni dhe teshtini.
- Praktikoni larjen e shpeshtë dhe të plotë të duarve me ujë të ngrohtë dhe sapun.
- Përdorni peceta të lagta që përmbajnë alkool ose dezinfektues për pastrimin e duarve.
- Shmangni prekjen e syve, hundës dhe gojës me duar.
- Ajrosni shpesh dhomën ku qëndroni gjatë kohës që jeni të sëmurë.
- Mbajeni mjedisin tuaj të pastër - objekte, sipërfaqe, me produkte higjienike shtëpiake.
- Nëse jeni mbi 65 vjet ose keni sëmundje kronike, ose nëse simptomat e sëmundjes përkeqësohen ose zgjasin për disa ditë - kërkoni ndihmë mjekësore.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

❖ Për sezonin 2025/2026, Ministria e shëndetësisë siguroi 80.000 doza të vaksinë katërvalente falas për grupet prioritet të popullatës.

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 16.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike, nga fillimi i vaksinimit e deri në përmbylljen e këtij raporti **gjithsej janë vaksinuar 77.365 persona të kategorive të cënueshme të popullatës me vakcina falas.**

❖ 2.400 vakcina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike **me vakcina komerciale janë vaksinuar gjithsej 1.852 persona.**

Në Maqedoninë e Veriut janë vaksinuar gjithsej 79.217 persona me vakcina falas dhe vakcina komerciale.

Tabela 2 Shpërndarja e numrit të vaksinuarve kundër gripit sezonal sipas grupeve të rrezikuara, RMV, 2025/2026

Grupi i rrezikuar	Sezoni 2025/2026	
	Numri i të vaksinuarve	%
Personat e moshuar (mbi 65 vjet)	48.415	61,1%
Fëmijët në moshë nga 6-59 muaj	63	0,08%
Personat mbi 6 muaj me sëmundje kronike	26.184	33,1%
Gratë shtatzëna	35	0,02%
Punonjësit shëndetësorë	2.647	3,3%
Tjetër	1.873	2,4%
GJITHSEJ	79.217	

Tabela 3. Numri i të vaksinuarve kundër gripit sipas javëve, sezoni 2025-2026

Java, sezoni 2025/2026	Numri i të vaksinuarve	Përqindja
java 42-43	31.289	39,5%
java 44-48	46.816	59,1%
java 49-52	865	1,1%
java 1-20	247	0,3%
GJITHSEJ	79.217	

RAJONI EVROPIAN

*Burimi: <https://erviss.org/>

Sipas Raportit të ERVISS të publikuar në javën e njëzetë të vitit 2026:

- Në javën e 20-të të vitit 2026 asnjë vend ose zonë në Rajonin Evropian të OBSH-së që raporton të dhëna nuk ka raportuar për sëmundje të ngjashme me gripin dhe/ose infeksioneve akute të frymëmarrjes mbi nivelet bazë.
- Indikatorët rajonalë për të tre viruset e frymëmarrjes ishin në nivele ndërsezonale.

Aktiviteti i viruseve respiratore

Në të gjithë Rajonin, përqindja e mostrave të pacientëve që janë paraqitur në pikat sentinel ose ARI që kanë rezultuar pozitivë për:

- **Influenza** mbeti nën pragun epidemiologjik prej 10%, në një nivel nën 1%, krahasuar me 1% në javën e kaluar. Pozitiviteti mesatar në 17 vende dhe zona ishte 0% (shtrirja: 0%-9%), dhe asnjë vend ose zonë nuk raportoi pozitivitet prej të paktën 10%.
- **SARS-CoV-2** mbeti në 2%, i njëjtë me javën e kaluar. Pozitiviteti mesatar në 18 vende dhe zona ishte 0% (shtrirja: 0%-4%).
- **RSV** mbeti në 1%, i njëjtë me javën e kaluar. Pozitiviteti mesatar në 14 vende dhe zona ishte 0% (shtrirja: 0%-9%).

Viruset e gripit të zbuluara me një lloj të njohur, të raportuara nga kujdesi parësor sentinel javën e kaluar (n=5), ishin kryesisht viruse të gripit të tipit A (n=3), dhe nga të nëntipizuarit (n=2), njëri ishte A(H1)pdm09 dhe një A(H3).

Nga 29 vendet dhe zonat që raportuan të dhëna për intensitetin e gripit: asnjë nuk raportoi intensitet të moderuar ose më të lartë.

Nga 28 vendet dhe zonat që raportuan shpërndarje gjeografike të gripit: 2 raportuan qarkullim rajonal ose të përhapur të gripit (Polonia dhe Mbretëria e Bashkuar - Irlanda e Veriut).

Viruset e gripit të zbuluara me një lloj të njohur, të raportuara nga mbrojtja shëndetësore primare sentinel javën e kaluar (n=5) ishin kryesisht Influenza A (n=3), dhe nga të subtipizuarit (n=2), njëri ishte A(H1)pdm09 dhe një A(H3).

Nga 29 vendet dhe zona që kanë raportuar të dhëna për intensitetin e gripit: asnjë nuk ka raportuar intensitet të moderuar ose më të lartë.

Nga 28 vendet dhe zonat që kanë raportuar shpërndarje gjeografike të gripit: 2 raportuan qarkullim rajonal ose të përhapur të gripit (Polonia dhe Mbretëria e Bashkuar - Irlanda e Veriut).

Ngarkesa e infeksionit


Në të gjithë Rajonin, përqindja e të gjitha mostrave të pacientëve që u paraqitën në vendet sentinel SARI që rezultuan pozitivë për:

- **Influenza** ishte nën 1%, krahasuar me 1% në javën e kaluar. Pozitiviteti mesatar nga 8 vendet dhe zonat që raportuan të dhëna ishte 0% (shtrirja: 0%-1%). Midis mostrave SARI, këtë javë u raportua 1 zbulim i virusit të gripit, dhe ishte tipi B (origjina e panjohur).
- **SARS-CoV-2** ishte në 1%, krahasuar me nën 1% në javën e kaluar. Pozitiviteti mesatar nga 7 vendet dhe zonat që raportuan të dhëna ishte 0% (shtrirja: 0%-1%).
- **RSV** ishte 2%, krahasuar me 5% në javën e kaluar. Pozitiviteti mesatar nga 7 vendet dhe zonat që raportuan të dhëna ishte 0% (shtrirja: 0%-10%).

Shkalla e vdekshmërisë nga COVID-19 mbeti e ulët në 9 vendet ose rajonet që raportuan të dhëna. Shkalla të ulëta të vdekshmërisë u raportuan tek njerëzit e moshës 65 vjeç e lart në të 9 vendet dhe rajonet këtë javë.

Këtë javë, vlerësimet e përbashkëta të EuroMOMO për vdekshmërinë nga të gjitha shkaqet për vendet evropiane pjesëmarrëse tregojnë nivele të pritura të vdekshmërisë në të gjitha grupmoshat. Të dhënat nga 27 vende evropiane ose rajone nënkombëtare u përfshinë në analizë.

Grafiku 7. Rastet pozitive me Influenza, SARS-CoV-2 dhe RSV dhe trendet javore, Evropë 2025/2026 (Burimi: ECDC)



[OBSh rekomandon që vakcina trivalente për përdorim në sezonin e gripit për hemisferën veriore 2026/2027](#) të pëmbajë:

Vakcina të bazuara në vezë:

- A/Missouri/11/2025 (H1N1)pdm09-like virus;

- A/Darwin/1454/2025 (H3N2)-like virus; dhe
- B/Tokyo/EIS13-175/2025 (B/Victoria lineage)-like virus.

Vakcina të bazuara në kultura qelizore ose me barë rekombinante:

- A/Missouri/11/2025 (H1N1)pdm09-like virus;
- A/Darwin/1415/2025 (H3N2)-like virus; dhe
- B/Pennsylvania/14/2025 (B/Victoria lineage)-like virus.